



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i dosjes: KSC-BC-2020-06
Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendos: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Parashtrues: Dr. Fidelma Donlon

Data: 9 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Njoftim i emërimit të bashkëmbrojtësit për Hashim Thaçin

me një shtojcë konfidenciale

Zyrës së Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit për Hashim Thaçin

Dejvid Hupër

1. Në përputhje me rregullën 26(1) të Rregullores,¹ Administratorja informon Gjykatësin e Procedurës Paraprake për miratimin e bashkëmbrojtësit për z. Hashim Thaçi ('z. Thaçi').
2. Më 7 nëntor 2020, mbrojtësi për z. Thaçi, z. Dejvid Hupër QC, e informoi shefin e Zyrës së Mbrojtjes se dëshironte të ndihmohej nga z. Dastid Pallaska si bashkëmbrojtës dhe i paraqiti dokumentet e duhura në përputhje me pjesën 18 të Direktivës për Mbrojtësit.²
3. Më 9 nëntor 2020, shefi i Zyrës së Mbrojtjes, pas konsultimeve me Administratoren, pranoi në mënyrë të kushtëzuar z. Pallaska në Listën e Mbrojtësve në përputhje me pjesën 7(2) të Direktivës për Mbrojtësit.
4. Më 9 nëntor 2020, Administratorja e miratoi z. Pallaska si bashkëmbrojtës për z. Thaçi në pajtim me pjesën 18 të Direktivës për Mbrojtësit, në pritje të vendimit përfundimtar për pranimin e z. Pallaska në Listën e Mbrojtësve.³
5. Ky parashtrim protokollohet si publik, ndërsa Shtojca 1 protokollohet si konfidenciale në përputhje me rregullën 82(1)(b) dhe (3) të Rregullores, meqenëse ajo përmban të dhëna personale të mbrojtësit dhe bashkëmbrojtësit.

Numri i fjalëve: 238 /në origjinal/

 /nënshkrimi/

Dr. Fidelma Donlon
Administratore

E hënë, 9 nëntor 2020
Në Hagë, Holandë

¹ Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara, KSC-BD-03/Rev3/2020, siç është ndryshuar më 29 dhe 30 prill 2020 ('Rregullorja'); *shih gjithashtu* Ligji Nr.. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015, nenet 21(4), 21(5), 34(7) dhe 41(4)(b).

² Direktiva për Mbrojtësit, KSC-BD-04, 6 nëntor 2017.

³ *Shih* Shtojca 1, Letra e miratimit, Përzgjedhja e bashkëmbrojtësit, KSC/REG/IOR/3315, 9 nëntor 2020.